



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 405/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Gjilan, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 12.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje.

Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 4350 (katërmijetreqindpesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Më datë 09.12.2010 ne orën 20:20, PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën pretendohet se më datë 09.12.2010 në orën 14:15 në rrugën Adem Jashari te Procredit Bank në Gjilan, anëtarët e subjekti politik PDK, kanë vënë posterat e kandidatit për deputet Zenun Pajaziti mbi posterat e Lëvizjes Vetëvendosje, që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.*

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 1 (një) fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterat e kandidatit për Kuvend të Republikës së Kosovës Zenun Pajaziti nga radhët e subjektit politik PDK është vendosur mbi posterin e kandidatit të Lëvizjes per Vetëvendosje. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik PDK, më datë 10.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 11.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi shqyrtoj dhe analizo shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se subjekti politik PDK shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi, rrjedhimisht konsiderohet si recidivist, rrethanë e cila ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar më gjobë. Prandaj për arsyet e lartcekura dhe ne kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 405/2010 më datën 12.12.2010

